



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:254853
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06859164

C.nr. 4002/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Y.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S. nga Dragashi, të cilin me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti kompensimin pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,275.00 (njëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë euro), jashtë seancës gjyqësore, më datë 18.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.S. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilarë të i paguajë (kompensojë) tre paga mujore neto në shumë prej 1,275.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”*
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi S.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datën 02 dhjetor 2022 ka parashtruar padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K.-Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave jubilarë, me vlerë të 1,275.00 (njëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë euro).

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës për më shumë se 37 vite në SHSKUK në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e nënshkruar më 12.06.2018 në mes të palëve për Qeveria e

Republikës së Kosovës- Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e 3 (tre) pagave neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës, lartësia e llogaritjes së 3 (tre) pagave neto për shpërblimin jubilar mbështetet në realizimin e pagës së muajit të fundit të paditësit. Tutje ka theksuar se sipas llogarisë, paga mujore dokumentohet nga shërbimi llogaritar i të paditurës, sipas kësaj paga mujore neto e paditësit është 425.00 euro, e cila vërtetohet nga lista e pagës, ku sipas përvojës së punës i takon shuma e përgjithshme prej 1,275.00 euro. Në fund ka theksuar pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave (obligative) të Kontratës Kolektive Sektoriale (nenit 17 par.3), Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, paditësi detyrohet që për realizimin e kësaj të drejte të i drejtohet gjykatës kompetente, ku njëherit i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e palës paditëse në padi. Ka theksuar se paditësi S.S. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ më 08.04.1985 deri më datë 15.03.1986, nga data 09.03.1987 deri më 21.12.2017, pastaj nga data 05.01.2022 ku edhe vazhdon të punojë, pas refuzimit të kërkesës për pagesë në emër të tre (3) pagave jubilarë i është drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tij. Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar nga arsyet se paditësi kërkesën e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në neni 52 dhe 53, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Në këtë drejtim, ka shtuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar pasi që në kuptim të Nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, kurse me dispozitat nga par.3 të këtij neni është paraparë që shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhet në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuar mbush 10, 20 dhe 30 vite përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut të ashtuquajtur vit jubilar. Në rastin konkret paditësi marrëdhënien e punës tek i padituri e ka themeluar më 08.04.1985 mund të konstatojmë se paditësi tek i padituri 30 vjet përvojë pune i ka mbushur më 08.04.2016, andaj ky vit për të ka qenë jubilar dhe paditësi në këtë vit nuk ka kërkuar pagesën për shpërblimin jubilar atëherë kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, gjithashtu MPKK nuk përmban dispozita retroaktive, i njëjti padin e ka parashtruar me datë 02.12.2022, në vitin në të cilin MPKK nuk ka qenë në fuqi. Andaj sipas kësaj paditësit nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Në fund ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë 10.06.2021. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësi, është në marrëdhënie pune te e paditura me një përvojë pune më shumë se 37 vjet, fakte këto që konstatohen nga vërtetimi i marrëdhënies së punës me numër të amzës 205 e datës 17.10.2022, të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm “ Prim, Dr. Daut Mustafa” në Prizren me të cilën vërtetohet fakti se i njëjti ka punuar nga data 08.04.1985 deri më datë 15.03.1986, nga data 09.03.1987 deri më 21.12.2017, pastaj nga data 05.01.2022 ku edhe ende vazhdon të punojë, të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës.

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e tre (3) pagave jubilarë.

Gjykata, në kuptim të Nenit 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD) i cili përcakton se “*Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë*” ka vlerësuar propësimin e ngritur nga e të paditurës si në përgjigjën në padi sa i përket parashkrimit të kërkesëpadsisë, dhe erdhi në përfundim se kërkesa e paditësit për pagesën e tre (3) pagave jubilarë, është përfshirë në parashkrim dhe atë për arsyet si në vijim:

Gjykata nga shkresat e lëndës konkretisht nga vërtetimi i lartcekur vërtetoi faktin se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm “ Prim, Dr. Daut Mustafa” në Prizren me të cilën vërtetohet fakti se i njëjti ka punuar nga data 08.04.1985 deri më datë 15.03.1986, nga data 09.03.1987 deri më 21.12.2017, pastaj nga data 05.01.2022 ku edhe ende vazhdon të punojë dhe se ka përvojë pune 36 vite, 10 muaj e 5 ditë. Me nenin 342 të LMD-së, parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashkuar diçka tjetër*” lidhur me kompensimin e tre (3) pagave jubilarë gjykata gjeti se paditësi kërkesën për kompensim pranë të paditurës e ka paraqitur me datën 02.12.2022, ashtu që paditësi vitin jubilar 30 e ka arritur me datën 08.04.2015, e që rrjedhimisht paditësit e drejta për të kërkuar kompensimin e tre (3) pagave jubilarë, i ka rrjedhur që nga data 09.04.2015 deri me datën 09.04.2018, datë kur ka mundur të parashtrijë padinë për realizimin e të drejtës në rrugë gjyqësore. Nga shkresat e lëndës, më konkretisht nga data 02.12.2022 kur pala paditëse e ka parashtruar padinë gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka rënë në vonesë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për realizimin e kërkesës së tij dhe atë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që “*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, andaj nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se paditësit nga data 08.04.2015 kur kërkesa e tij është bërë e arritshme e ka lëshuar afatin prej tre (3) vitesh për të kërkuar realizimin e të drejtës në kompensimin e tre (3) pagave jubilarë.

Po ashtu me nenin 341 par.1 të LMD-së parashihet “*Me parashkrim shuhet e drejta e kërkitit të përmbushjes së detyrimit*” paragrafi 2 i nenit 341 të LMD-së parasheh “*Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit*”.

Mbi këtë bazë, Gjykata vërtetoi faktin se kërkesa e paditësit ka arritur afatin e parashkrimit dhe rrjedhimisht detyrimi i të paditurës tanimë nuk paraqet detyrim civil i cili mund të realizohet në rrugë gjyqësore.

Poashtu gjykata gjeti se i njëjti e ka paraqitur padinë në kohën kur kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë e datës 12.06.2018, në të cilën paditësi e ka bazuar padinë e tij nuk ka qenë në zbatueshmëri, për faktin se e njëjta ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri me datë 10.06.2021.

Sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e palës paditëse, gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*.

Bazuar në dispozitat e Nenit 399.1 të LPK-së, Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësit ishte qartazi e pathemeltë, sepse e njëjta është përfshirë në parashkrim, dhe në mungesë të ndonjë akti tjetër juridik në fuqi që e njeh të drejtat e pretenduara të paditësit, gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 450 të LPK-së pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar ato.

Nga arsyet e cekura me lartë dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:254853, 18.02.2025

Gjyqtari,

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2022:254853
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06859164